



# NJË UDHËZUES BURIMESH PËR IMIGRANTËT NJUJORKEZË

Qyteti i Nju-Jorkut i mbështet të gjithë banorët e vet, pavarësisht statusit të imigrimit. Ndiham, në mbi 200 gjuhë, është një telefonatë apo klikim larg. **Këtu jepet një udhëzues i shpejtë se nga t'ia nisni:**

## NDIHMA LIGJORE PËR IMIGRANTËT

- **Telefononi falas "ActionNYC" në 1-800-354-0365** nga e hëna në të premte, 09:00 – 18:00, për ndihmë të sigurt ligjore për imigrantët
- **Telefononi 311 dhe thoni "citizenship appointment" (takim për nënshtetësinë) ose vizitoni NYC.gov/NYCCitizenship** për ndihmë me aplikimin për nënshtetësi dhe këshillim financiar falas, të disponueshme në bibliotekat e zgjedhura publike
- Bëni kujdes nga ofruesit e shërbimeve të imigrimit që përfitojnë nga klientët e tyre. Merrni ndihmë vetëm nga një avokat i besuar e i licencuar ose nga një përfaqësues i akredituar. Për pyetje në lidhje me këtë, **telefononi linjën e drejtpërdrejtë (hotline) për Amerikanët e Rinj në 1-800-566-7636** nga ora 09:00-20:00, nga e hëna në të premte

## MBROJTJA DHE FUQIZIMI I FAMILJEVE



### KUJDESI SHËNDETËSOR

Të gjithë kanë nevojë për ndihmë ndonjëherë dhe askush nuk duhet të mundohet i vetëm. Kujdesi shëndetësor jourgjent dhe urgjent me kosto të ulët disponohet për të gjithë në spitalet dhe klinikat publike dhe në klinika të tjera të përbalueshme. "NYC Well" është shërbimi falas i referimit, informimit, ndërhyrjes në raste krizash dhe mbështetjes konfidenciale i qytetit të Nju-Jorkut për këdo që kërkon ndihmë për problemet me shëndetin mendor dhe/ose abuzimin me substancat, i disponueshëm 24 orë në ditë, 7 ditë në javë, 365 ditë në vit, në mbi 200 gjuhë. **Telefononi 1-888-NYC-Well ose dërgoni mesazhin WELL në 65173.**



### ARSIMI

**Regjistrojini fëmijët tuaj në shkollë.** Çdo fëmijë në qytetin e Nju-Jorkut ka të drejtën e arsimimit në një shkollë publike, pavarësisht statusit të imigrimit apo gjuhës. Fëmijët e moshës 4-vjeçare ose që mbushin 4 vjeç kualifikohen për programin parashkollor (Pre-K) dhe të gjithë banorët gëzojnë të drejtën të ndjekin shkollën publike nga moshë 5 vjeç deri në diplomim ose deri në fund të vitit shkollor kur mbushin 27 vjeç. Për t'u regjistruar në "3-K", "Pre-K" apo ndonjë shkollë të Departamentit të Arsimit (Department of Education, DOE), **telefononi 311 ose vizitoni schools.nyc.gov/enrollment.**



### KUJDESI PËR FËMIJËT

Kujdes për fëmijët, falas ose me kosto të ulët. Familjet me të ardhura të ulëta me fëmijë të moshës 6-muajsh deri në 12 vjeç mund të përfitojnë ndihmë për fëmijët, falas ose me kosto të ulët. **Vizitoni NYC.gov/ACS ose telefononi 311 për të mësuar më shumë.**



### USHQIM DHE STREHIM NË RASTE EMERGJENCE

**Ushqim falas për personat në nevojë.** Pika në të gjithë NYC-në ofrojnë ushqim falas për personat në nevojë. Programi "HomeBase" mund t'i ndihmojë banorët të shmangin hyrjen në sistemin e strehimit. **Vizitoni NYC.gov/Homebase ose telefononi 311 për të mësuar më shumë.**

## MBAJTJA E KOMUNITETEVE TONA TË SIGURTA



### SIGURIA PUBLIKE

Qyteti nuk zbaton masa shtrënguese në lidhje me imigrimin. NYPD-ja nuk i pyet për statusin e imigrimit viktimat e krimit, dëshmitarët apo personat e tjerë që kërkojnë ndihmë. Kushdo që është bërë viktimë e një krimi të nxitur nga urrejtja, ose që nuk ndihet i sigurt, duhet të kontaktojë NYPD-në. **Për të kontaktuar drejtpërdrejt Task Force e NYPD-së për Krimet e Nxitura nga Urrejtja, telefononi 1-646-610-5267.**



### MBROJTJA NGA DISKRIMINIMI

Të gjithë njujorkezët gëzojnë të drejtën të mos jenë objekt i diskriminimit, penalizimit dhe ngacmimit në vendin e punës, në vendstrehim dhe në vende publike. Për të paraqitur një ankesë ose për të mësuar më shumë, **telefononi 311 ose Komisionin e Qytetit të Nju-Jorkut për të Drejtat e Njeriut (NYC Commission on Human Rights) në 1-718-722-3131.**

## MERRNI FALAS IDNYC TUAJ – KARTËN E IDENTITETIT



**Për të marrë IDNYC-në tuaj, lini një takim sot. Telefononi 311 dhe thoni "IDNYC" ose vizitoni NYC.gov/IDNYC.** IDNYC-ja është një kartë identiteti falas për të gjithë njujorkezët 10 vjeç e lart dhe ofron me dhjetëra përfitime të mëdha. IDNYC-ja **nuk** mbledh informacion për statusin e imigrimit dhe të dhënat e aplikantëve janë konfidenciale. Qyteti i mbron të dhënat e IDNYC-së deri në masën maksimale me ligj.